

VENDIM
Nr. 33, datë 23.1.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I NJË QENDRE MULTIFUNKSIONALE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA”, NË FSHATIN POSHNJE, BASHKIA URA VAJGURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i një qendre multifunkionale për fëmijët me aftësi të kufizuara”, në fshatin Poshnje, Bashkia Ura Vajgurore.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgurore.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, për pasurinë e llojit “ndërtesë”, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 783 335 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasurinë e llojit “ndërtesë”, me vlerë 783 335 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgurore.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i përmendur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidimin, pranë Bashkisë Ura Vajgurore.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgurore, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Ura Vajgurore, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit

**“Ndërtimi i një Qendre Multifunkionale për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar”, në fshatin
Poshnje, Bashkia Ura Vajgurore**

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi i objektit	Vlera në lekë	Shënime sqaruese
1	Islam Halim Qemalaj	Ndërtesë (banim)	3032	456/6+1-4	60	60	783355	783335	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale paraprake						60	783335		

Sbënim. Vlerat e shpronësimit është llogaritur në bazë të kostos së ndërtimit, bazuar në çmimet e Entit të banesave për qytetin e Beratit për vitin 2016.

